



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.953/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit NTP PBC Group me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.S. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ask Tec DOO me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit I.O.S. avokate nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e palëve ndërgjyqëse, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.843/22 të datës 27.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar Ankesa e paditësit NTP PBC Group me seli në Prishtinë, dhe Ankesa e të paditurës Ask Tec DOO me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.843/22 i datës 27.04.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.843/22 të datës 27.04.2023, dhoma e shkallës së parë, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP PBC Group dhe Detyrohet i padituri Ask Tec DOO, që paditësit për kompensimin e dëmit për shkak të mos përmbushjes së kontratës nr.1104/2 dt.19.03.2013, t,ia paguaj në emër të fitimit të humbur shumën prej 598.10€, në emër të dëmit të shkaktuar (konfiskimi i policës) shumën prej 987.65€, në shumë të përgjithshme prej 1,585.75€, ma kamatë ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 18.05.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, II. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit NTP PBC Group, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Ask Tec DOO, që në emër të kompensimit të dëmit për dëmtimin e imazhit t,ia paguaj shumën prej 100,000.00€ (njëqind mij euro) me kamatë ligjore sias normës së interesit vjetor prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit

të padisë 18.05.2015 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, III Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi kanë paraqitur ankesë përfaqësuesit e autorizuar të palëve ndërgjyqëse.

I autorizuari i paditësit B.S. avokat në Prishtinë, me ankesë, kundërshton aktgjykimin e atakuar për shkak të refuzimit të kërkesës për kompensimin e dëmit sa i përket dëmtimit të imazhit, shpenzimeve të procedurës me propozimin që Dhomat e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën në tërsi si të bazuar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar.

E autorizuar e paditurit I.O.S. avokate në Prishtinë, me ankesë kundërshton pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjyimit, për shkak të shkeljes thelbësore të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të Ligjit, me propozim që të miratohet si e bazuar ankesa e paditurit të ndryshohet aktgjykimi KE.nr.843/22 datës 27.04.2023 në pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjyimit ashtu që: Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadija e paditësit kundër të paditurit me kërkesë për kompensim të dëmit material në shumën prej 1,585.75€, të Detyrohet paditësi që paditurit t,ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 5,692.25€, ose të aprovohet ankesa e paditurit, të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

Në përgjigjen në ankesë e autorizuar e paditurit thekson se ankesa e paditësit është kundërthënëse dhe nuk përmban shkaqet për të cilat goditet aktgjykimi sipas kërkesës ligjore, dhe i propozon gjykatës të refuzohet ankesa e paditësit në tërsi si e pabazuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi NTP PBC Group me seli në Prishtinë, me datën 18.05.2015 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Ask Tec DOO me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, dhe ka kërkuar nga gjykata kompensimin e dëmit material për shkak të mos përmbushjes së kontratës dhe dëmit jomaterial për prishjen e mazhit dhe reputacionit me kamatë prej 8% duke filluar deponimi i padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit. Në parashtrësën e datës 11.05.2018 paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë me të cilën ka kërkuar shumat: në emër të fitimit të humbur shumën prej 598.10€, në emër të dëmit të shkaktuar (konfiskim i policës) shumën prej 987,65€ si dhe në emër të dëmit jo material për prishjen e imazhit dhe reputacionit shumën prej 100,000.00€.

Në seancat gjyqësore përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se paditësi dhe i padituri me datë 19.03.2013 kanë lidhur kontratë me nr.1104/2 për bashkëpunim afarist për “furnizim me produkte dhe shërbime të teknologjisë informative”. Paditësi ka marr pjesë në procedurën e prokurimit të shpallur nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm dhe është shpall fitues për furnizimin me paisje të teknologjisë informative dhe për përmbushjen e obligimeve sipas kontratës me ZAP, paditësi ka

bërë porosinë e mallit me datë 04.11.2013 në vlerë prej 9,278.40€ ku afati i fundit për liferimin e tij ka qenë data 09.12.2013, mirëpo përkundër interesimit dhe insistimit të vazhdueshëm të paditësit që të bëhet liferimi i mallit, i padituri ka dështuar ta bëjë atë. Për shkak të dështimit të liferimit të mallit ZAP përmes shkresës elektronike, paditësin e ka cilësuar si kompani joserioze, dhe e ka njoftuar se është bërë anulimi i kontratës dhe se do të bëhet ekzekutimi i garancionit. Për shkak të lëshimeve të paditurit, paditësit i është shkaktuar dëm material dhe jo material nga aspekti i imazhit dhe reputacionit me kualifikimin si kompani joserioze nga ZAP, andaj mbi bazën e këtyre ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë në tësi si të bazuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e paditurit në seancat gjyqësore deklaroi se raporti kërkesë oferte për furnizimin me pajisje elektronike për ZAP, sipas kontratës së paditësit dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm nr.302 013 014-1-2-1 dt.05.11.2013 ka ekzistuar në mes paditësit dhe prodhuesit Hewlett Packard dhe jo në mes paditësit dhe paditurit, ndërsa kontrata për furnizim në mes palëve ndërgjyqëse është një kontratë kornizë meqë çmimi i mallrave dhe shërbimeve do të përcaktohet nga rasti në rast, me një dokument të emërtuar “ofertë” i cili përmban numrin e ofertës, datën, llojin e produkteve/shërbimeve, sasinë, çmimin me të gjitha taksat e aplikueshme dhe do të ndërlidhet me titullin dhe numrin e kësaj kontrate, e cila rregullon vetëm të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga raporti i porosisë/ofertës në mes paditësit dhe paditurit dhe jo paditësit dhe prodhuesve të paisjeve. Në këtë çështje kontestuese i padituri ka pasur vetëm rolin e ndërmjetësuesit dhe se përfshirja e tij si ndërmjetës ka pasur për qëllim që paditësi të përfitoj çmime më të volitshme dhe të përfitoj nga shërbimet logjistike për porosinë të cilën i njëjti ia ka drejtuar prodhuesit. I padituri nuk ka pasur përgjegjësi për çfarëdo dëmi që i është shkaktuar paditësit, për faktin se nuk ka pasur kërkesë sipas kushteve të kontraktuara në mes palëve ndërgjyqëse dhe se prodhuesi dhe paditësi kanë hyrë në raport direkt të shitblerjes së mallrave të porositura dhe se prodhuesi ka marrë përgjegjësi në mënyrë të drejtpërdrejt për mungesat e mallit për shkak të mungesës së materialit në stok. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit të refuzoj në tësi si të pabazuar.

Dhoma e shkallës së parë, duke vepruar sipas vërejtjeve të dhëna nga aktvendimi A.e nr.208/18 datës 21.07.2020 i Gjykatës së Apelit, pas administrimit të provave në seancën gjyqësore datës 12.04.2023 e mbajtur në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, ka marrë aktgjykimin ankimor, me të cilin ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit ankimor.

Në arsyetim të aktgjykimit, dhoma e shkallës së parë, ka nxjerrë konstatimin se nga provat e administruara rezulton se pala e paditur nuk e ka përmbushur kontratën sipas kushteve kontraktuese duke i shkaktuar paditësit dëm material, të cilit i është konfiskuar garancioni kontraktues si dhe ka pësuar dëm në formë të fitimit të humbur nga shkëputja e kontratës së prokurimit me ZAP. Gjykata referohet në nenin 245 të LMD-së kur e mban paditurën përgjegjëse për mos përmbushjen e kontratës duke i shkaktuar paditësit dëm material. Lartësinë e shumës së gjykuar për kompensimin e dëmit për fitimin e përealizuar (fitimin e munguar) në shumë prej 598.10€ dhe dëmin e pësuar nga konfiskimi i garancionit në shumë prej 987.65€, gjykata e ka përcaktuar në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit R.F. në ekspertizën financiare datës 12.03.2018. Gjykata ka vlerësuar se i padituri është palë kontraktuese respektivisht në cilësinë e shitësit ka marrë përsipër të furnizoj

paditësin me mallrat e kontraktuara sipas kontratës nr.1104/12 dt.19.03.2013, ndërsa komunikimi i paditësit me prodhuesin ka qenë vetëm me qëllim të lehtësimit të punës, andaj i padituri ka përgjegjësi të plotë për mos përmbushje të kontratës dhe dëmin e shkaktuar paditësit. Gjykata gjeti se pretendimet e paditësit lidhur me kompensimin e dëmtimit të imazhit në shumën prej 100,000.00€ janë të pabazuara sepse paditësi nuk kishte siguruar prova që vërtetojnë ekzistimin lidhjes shkakore mes veprimeve të paditurit dhe dëmit të pësuar dhe bazës ligjore për kompensimin e dëmit. Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së.

Dhomat e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të dhomës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1 dhe 2 pika (n) e LPK, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, apo për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, të cilat shkelje pretendohen në dy ankesat e palëve ndërgjyqëse.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerësoi se dhoma e shkallës së parë, ka vepruar drejt kur me aktgjykimin e atakuar, ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, sepse ky aktgjykim gjen mbështetje të mjaftueshme në aspektin e vërtetimit të gjendjes faktike duke marrë për bazë lartësinë e dëmit të pësuar ndaj paditësit, për shkak të mos përmbushjes së kontratës nr.1104/12 e lidhur mes palëve ndërgjyqëse me datën 19.03.2013 për “furnizim me produkte apo shërbime të teknologjis informative” me të cilin veprim i padituri i ka shkaktuar dëm paditësit për mos liferimin e mallit të kontraktuar, e që në rastin konkret autoriteti kontraktues Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka shkëputur kontratën e lidhur me paditësin “furnizimin me laptopa dhe docking station për stafin e ZAP me numër identifikues 302 014 002 1-2-1”, për shkak të mos liferimit të mallit të kontraktuar sipas kushteve kohore të kontraktuara, dhe ky kompensim i dëmit i shkaktuar ndaj paditësit referohet në emër të fitimit të humbur shumën prej 598.10€ dhe konfiskimit të garancionit të policës nr.037326, shumën prej 987.65€.

Kolegji vlerësoi se me të drejtë dhoma e shkallës së parë, ka bërë përgjegjës paditurin për shkak të mos përmbushjes së kontratës duke mos ia kompensuar dëmin e shkaktuar paditësit, ka aprovuar shumën e kompensimit të dëmit në emër të fitimit të humbur dhe konfiskimit të garancionit kontraktues, duke e obliguar të paditurin që t,ia paguaj paditësit shumën e përgjithshme prej 1,585.75€. Kjo shumë është vërtetuar edhe nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit financiar z. R.F., të dhënë në ekspertizën e tij të datës 12.03.2018, e të cilat konstatime kanë mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë vlerëson, se dhoma e shkallës së parë në rastin konkret, me të drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 245 të LMD-së, që parasheh:

Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.

Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se kjo dispozitë ligjore e lartcekur gjen mbështetje në rastin konkret, sepse nga gjendja e fakteve të vërtetuara gjatë administrimit të provave nga dhoma e

shkallës së parë, me drejtë është konstatuar gjendja faktike, se detyrimi i të paditurit rrjedh nga kontrata e lidhur mes palëve në procedurë për furnizim me produkte a shërbime të teknologjisë informative e datës 19.03.2013. Provat e siguruar gjatë procesit gjyqësor nga dhoma e shkallës së parë, respektivisht komunikimet-emailat e paditësit me prodhuesin Hewlett Packard, në drejtim të lehtësimit të punës për furnizimin e mallit të kontraktuar, nuk e përjashton përgjegjësin e paditurit për mos përmbushje të kontratës dhe dëmit të shkaktuar paditësit. Kolegji gjithashtu vlerësoi se dhoma e shkallës së parë ka vërtetuar drejt gjendjen faktike nga provat e administruara kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësin për kompensimin e dëmit për dëmtimin e imazhit në shumën prej 100,000.00€, sepse edhe Kolegji pranon konstatimet në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar se paditësi nuk ka ofruar prova konkrete se të njëjtit i është pamundësuar fitimi i kontratave tjera për shkak të dëmtimit të imazhit nga mos përmbushja e kontratës me zyrën e auditorit, prandaj nga provat e administruara si: Njoftimet për dhënie të kontratës dt.24.10.2013, 03.06.2014, 15.04.2015, 09.07.2015 me ZAP, Doganën e Kosovës, MFSK, nuk është vërtetuar se paditësit i është pamundësuar fitimi i kontratave tjera, por i njëjti ka vazhduar të fitoj-realizoj kontrata me autoritete publike të lartcekura, edhe pas anulimit të kontratës më Zyrën e Auditorit të përgjithshëm.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me gjendjen faktike dhe dispozitat e LMD-së, kur ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë sa i përket dëmit jo material në shumën prej 100,000.00€, dhe se gjykata nuk ka arsyetuar fare vendimin për shpenzimet nga neni 452.2 të LPK-së. Kolegji vlerëson se nga provat e administruara pranë dhomës së shkallës së parë, nuk është siguruar ekzistimi i lidhjes shkakore mes veprimeve të paditurit dhe dëmit të pësuar dhe bazës ligjore për kompensimin e dëmit jo material për shkak të dëmtimit të imazhit sikurse pretendon paditësi-ankuesi në ankesë, në arsyetim të aktgjykimit, janë dhënë prova bindëse dhe të argumentuara se paditësi ka vazhduar të realizoj kontrata të prokurimit me autoritetet publike. Ndërsa sa i përket pretendimeve për vendimin për shpenzimet e procedurës, Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin kur ka aplikuar nenin 452.2 të LPK-së, duke marrë për bazë suksesin në këtë proces gjyqësor.

Po ashtu, Dhomat e Shkallës së dytë, i vlerëson si të pabazuara pretendimet ankimore të së paditurës se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të dispozitave nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së, pse i dha besimin njërës ekspertizë kur ka pasur dy ekspertiza me konstatime të kundërta, dhe nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike sa i përket raportit kontraktual mes paditësit dhe prodhuesit, nuk janë analizuar drejt dispozitat e kontratës nr.1104/12 datës 19.03.2013, gjykata nuk ka zbatuar drejt dispozitat e nenit 452.2 të LPK-së sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale. Kolegji vlerësoi se nga provat e administruara nga dhoma e shkallës së parë, pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Kolegji vlerësoi se aktgjykimi ankimor nuk është në kundërshtim me nenin 182.2 pika (n) e LPK-së, ngase është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, ndërsa sa i përket përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar për mos përmbushje të kontratës nr.1104/12 datës 19.03.2013, Kolegji vlerëson se i padituri i cili ka hy në raport

kontraktues me paditësin për furnizim me produkte a shërbime të teknologjis informative, nuk ka arritur që ta furnizoj me kohë paditësin sipas kushteve kontraktuale, dhe mbajtja e komunikimeve elektronike të paditësit me prodhuesin, nuk e përjashton të paditurin nga përgjegjësia për mos përmbushje të kontratës, prandaj në këtë rast edhe Kolegji vlerëson se me të drejt dhoma e shkallës së parë i ka falur besimin mendimit dhe konstatimit të ekspertizës financiare datës 12.03.2013 e punuar nga ekspertit financiar R.F., se mos liferimi i mallit të porositur nga paditësi tek i padituri, i cili mall ka qenë i dedikuar për zyrën e auditorit të Përgjithshëm, është direkt përgjegjësi e paditurit, me të cilin paditësi ka pasur kontratë, dhe i cili nuk iu ka përmbajtur kontratës për liferimin e mallit sipas afateve të kërkuara, me çka edhe i është shkaktuar dëm paditësit në shumën prej 987.65€ në emër të konfiskimit të garancionit sipas policës dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 598.10€, për shkak të shkëputjes së kontratës nr. 302014002 1-2-1 nga ZAP. Prandaj Kolegji vlerësoi se ekspertiza tjetër financiare e datës 05.11.2017 e punuar nga R.B., e cila e trajton të paditurin si ndërmjetës në këtë rast mes paditësit dhe prodhuesit, vetëm në bazë të e-maileve elektronike, nuk është në pajtim me provat e lëndës dhe me kontratën nr.1104.12 e datës 19.03.2013 e lidhur mes dy palëve ndërgjyqëse. Kolegji vlerësoi se dhoma e shkallës së parë ka zbatuar drejt ligjin kur ka aplikuar nenin 452.2 të LPK-së, duke marrë për bazë suksesin në këtë proces gjyqësor.

Dhomat e shkallës së dytë, i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse dhoma e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse në arsyetimin e aktgjykimit, të cilën e pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa pretendimet e palëve ankimore janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.952/2023 datë 22.02.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari
Krenar Berisha